

## **Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Sektori i Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë zhvillojnë analizën vjetore të punës për vitin 2021**

Në datën 10 shkurt 2022, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, dhe Sektori i Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë në zbatim të Urdhrit nr. 8, datë 18.01.2022 të Kryetarit të KLSH, “Për Kryerjen e Analizës Vjetore të Veprimtarisë së Departamenteve të KLSH-së, për Vitin 2021”, zhvilluan në mjediset e Kontrollit të Lartë të Shtetit, analizën vjetore të vitit 2021.

Në këtë analizë morën pjesë Drejtuesja e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore Znj. Edlira Sako, Përgjegjësjë e Sektorit të Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me jashtë Znj. Dëshira Huqi dhe stafet përkatëse, gjithashtu pjesëmarrës në këtë analizë ishte dhe Sekretari i Përgjithshëm i Kontrollit të Lartë të Shtetit, znj. Valbona Gaxha.

Znj. Edlira Sako, theksoi se qëllimi i një SAI është që të përmirësojë vazhdimisht performancën e tij, dhe kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet një stafi i cili është i motivuar, është i mirë menaxhuar si dhe që shpërblehet në mënyrë të drejtë. Përgjatë vitit 2021, KLSH ka vijuar të adresojë Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, në një linjë me objektivat e përcaktuara në Dokumentin e Politikave të Burimeve Njerëzore, miratuar me Vendim të Kryetarit nr. 228, datë 31.12.2017. Për vitin 2021 është miratuar struktura organike me një total prej 218 punonjësish. Numri i stafit Kryeauditues dhe atij Auditues në vitin 2021 është 148 punonjës. Duke iu referuar profilit të diplomimit, klasifikimi i punonjësve me arsim të lartë është: 45 Financierë, 6 Kontabilistë, 33 Ekonomistë të ndryshëm, 40 Juristë, 28 Inxhinierë, 24 punonjës me diploma të tjera. Klasifikuar sipas arsimimit, në strukturën organike për vitin 2021, punonjësit me arsim të lartë janë 176 punonjës. Gjatë vitit 2021 janë ndjekur të gjitha procedurat sipas rregullave dhe dispozitave ligjore në fuqi mbi nëpunësit civil, për rekrutimin e 32 punonjësve. Për vitin 2021 përbërja e punonjësve sipas funksioneve dhe detyrave që kryejnë ka qenë: 16 Personel drejtues (ku përfshihen Kryetari, Drejtori i Kabinetit, Drejtor i Përgjithshëm, Sekretar i Përgjithshëm, Drejtorët e Departamenteve e të Drejtorive, Këshilltarë); 13 Kryeauditues, 136 Auditues, 31 Punonjës mbështetës. Moshë mesatare në KLSH në fund të vitit 2021 është 41.9 vjeç. Raporti femra/meshkuj 43 % me 57% për vitin 2021. Rezultojnë të punësuar në Institucion 81 punonjëse femra, 9 prej të cilave në pozicione drejtuese, 11 punonjëse femra në Departamente, Drejtori dhe Sektorë mbështetës e ndihmës dhe 61 punonjëse femra në pozicione audituese.

Në punën e tij **Sektori i Protokoll-Arkivit** mbështetet në Ligjin nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Rregulloret e Brendshme të KLSH, në Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, rregulloret e normat e miratuara në zbatim të ligjit “Për arkivat”. Gjatë vitit 2021 janë regjistruar 1435 numra bazë në protokollin e korrespondencës, të cilat përfaqësojnë numerizimin e praktikave të çelura për vitin 2021 për dokumente të krijuara nga KLSH dhe dokumente të ardhura në adresë në KLSH, pa marrë parasysh këtu numrin e veprimeve në fraksion të këtyre praktikave. Janë regjistruar 238 Vendime dhe 138 Urdhra të Kryetarit të KLSH. Janë plotësuar kërkesat dhe autorizimet e bëra nga Drejtoritë dhe Departamentet e KLSH për vënien në shfrytëzim të dokumenteve të fondit arkivor të institucionit në 194 praktika.



**Sektori i Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë**, gjatë prezantimit u ndal në detyrat që mbulon, në realizimin e objektivave të vitit që lamë pas, në punën e bërë, në pritshmëritë për vitin 2022 dhe në problematikat e hasura.

Në mënyrë që KLSH të komunikojë efektivisht vlerën dhe përfitimet e veprimtarisë së tij tek palët e interesit është synuar rritja e profilit publik të KLSH-së dhe e të kuptuarit të misionit, vizionit dhe rolit të tij në shoqëri dhe promovimin i rezultateve të auditimit të KLSH-së për të transmetuar tek opinionin publik dobinë e institucionit në përmirësimin e qeverisjes, përmes luftës kundër korrupsionit. Hartimi i politikave të qarta të komunikimit me fokus rritjen e besimit të publikut, zgjidhjen e problematikave që lidhen me veprimtarinë e KLSH-së, si dhe gjithëpërfshirjen sociale.

Në këtë analizë vjetore u raportua mbi promovimin e rolit kushtetues të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe ndërgjegjësimin publik për rezultatet e auditimit nëpërmjet përgatitjes dhe publikimit të informacioneve për auditime me ndjeshmëri të veçantë për Kuvendin dhe opinionin publik. Në faqen e KLSH-së janë publikuar 100 raporte auditimi. Me fokusin tek rritja e transparencës dhe komunikimi interaktiv me qytetarin, KLSH ka publikuar 66 njoftime për shtyp nëpërmjet të cilave është synuar informimi i të gjitha palëve të interesit me rezultatet e punës audituese. Në kuadër të angazhimit të KLSH-së në luftën pa kompromis kundër korrupsionit dhe keq përdorimit të fondeve publike 12 prej njoftimeve për shtyp kanë informuar publikun për kallëzimet penale që KLSH i ka përcjellë SPAK dhe Prokurorisë. Rritja e profilit publik të KLSH-së nëpërmjet intensifikimit të bashkëpunimit me median e shkruar dhe atë audiovizive është një objektiv i këtij Sektori i realizuar nëpërmjet publikimit të 66 njoftimeve për shtyp nga të cilat 12 njoftime për kallëzimet penale. 262 artikuj të publikuar nga media e shkruar për aktivitetin auditues të KLSH-së. Trajtimi i aktivitetit të

Kontrollit të Lartë të Shtetit është pasqyruar në 400 artikuj në median sociale dhe kronika televizive.

Intensifikimi i komunikimit me SAI-et homologe me synim shkëmbimin e eksperiencave profesionale është synuar nëpërmjet pjesëmarrjes së përfaqësuesve të KLSH-së në 44 takime, seminare, workshop-e dhe trajnime me një total prej 437 ditë/ njerëz.

Rritja e komunikimit të brendshëm në KLSH dhe shkëmbimit të informacionit midis Drejtorive dhe Departamenteve të auditimit është realizuar nëpërmjet komunikimit të vazhdueshëm me strukturat e KLSH për hartimin e raportimeve të ndryshme.